



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerën 363,721€, pasi që Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike joadekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B2 Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

B3 Vonesë në pagesën e faturave

A1 Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kamenicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kamenicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kamenicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kamenicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm.

Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në menxhimin e pasurisë, përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, personelit, pagesa e faturave brenda 30 ditëve, dhe klasifikimi i shpenzimeve, të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Raporti i auditimit ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 363,721€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre, nga kategoria e investimeve kapitale ishin dy (2) pagesa në vlerë 110,000€, nga subvencionet dhe transferet dy (2) pagesa në vlerë 99,470€ si dhe nga mallrat dhe shërbimet shtatë (7) pagesa në vlerë 154,251€. Këto pagesa do të duhej të paguheshin nga kategoria e pagave dhe meditimeve.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjen adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja

Ligji për Zyrat e Publik Nr. 08/L-197, neni 101 përcakton që: “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës për Prokurimit Publik”. Derisa Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurim Publik, Neni 57, paragrafi 57.3, “Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por të cilat shërbime nuk mund t’i plotësojë me stafin që ka”. Po ashtu, neni 10.6 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 thotë se: “Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se 120 dite brenda një (1) viti.

Komuna kishte angazhuar 32 punonjës përmes “Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV)”, pa respektuar procedurat e prokurimit publik dhe pa aplikuar procedurë të rekrutimit me kriterë përzgjedhëse. Për më tepër, angazhimi i tyre ka qenë për kryerjen e detyrave që i përkasin pozitave të rregullta të punës, e jo për shërbime të veçanta apo detyra specifike, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, kohëzgjatja e kontratave në 10 (dhjetë) raste ishte më gjatë se koha e lejuar ligjore prej 4 (katër) muajsh.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së pozitave të aprovuara të vendeve të punës më ligjin për buxhetin e RK-së.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit dhe procedurave tjera përkatëse për angazhim të stafit ndikon në mos zbatimin e kërkesave ligjore dhe në transparencën e procesit. Kjo praktikë eliminon konkurrencën e hapur dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e punës.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se për angazhimet për shërbime të veçanta dhe detyra specifike, aplikohen procedurat e prokurimit sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesë në pagesën e faturave

Gjetja

Neni 39.1 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, përcakton që “ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”.

Në katër (4) raste, faturat në vlerë totale prej 161,749€ të paraqitura në pasqyra financiare, nuk ishin paguar nga komuna brenda afatit ligjor. Këto raste përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesa që arrijnë deri në 43 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Si pasojë e kësaj vonesë në pagesat, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave dhe gjobave për vonesat e kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimi të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve

Gjetja

Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15, pika 2 përcakton se; Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte arritur të përmbushë kuotën ligjore për të paktën 20% për inspektim të të gjitha objekteve-parcelave brenda territorit të Komunës. Nga gjithsej 14,500 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka kryer 1,294 verifikime nga të gjitha objektet apo rreth 9%. Niveli i përqindjes së verifikimit është i ulët, prandaj kërkohen ende veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në të terren.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë dhe mungesës së anketuesve në terren.

Ndikimi

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 93,143,855€, pasurive jokapitale është 351,449€, si dhe stoqeve 18,812€.

Çështja C1 - Mospërputhje e njësive të pasurive jo kapitale ndërmjet sistemit të E-pasurisë dhe raportit të inventarizimit

Gjetja

Regullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6 paragrafi 1 përcakton se: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Nga testimet tona kemi vërejtur se në sistemin e E-pasurisë ishin të regjistruara mbi 11,558 njësi të pasurive jo financiare (nën 1,000€), ndërsa bazuar në raportin e inventarizimit, ishin evidentuar 20,846 njësi të cilat nuk ishin të regjistruara në E-pasuri. Këto pasuri janë kryesisht inventarët e qendrave të mjekësisë familjare (QMF) dhe shkollave.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive në procesin e evidentimit, raportimit dhe monitorimit të pasurive jo financiare nën 1,000€ në sistemin e E-pasurisë.

Ndikimi

Mospërputhja ndërmjet regjistrimeve në sistemin e E-pasurisë dhe raportit të inventarizimit tregon për mangësi në evidentimin dhe kontrollin e pasurive jo financiare nën 1,000 €, duke rezultuar në regjistra jo të plotë dhe jo të besueshëm që ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive në pasqyrat financiare. Kjo rrit rrezikun e humbjes apo keqpërdorimit të tyre dhe dobëson menaxhimin dhe monitorimin efektiv të pasurisë nga ana e menaxhmentit.

Rekomandimi C1

Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet harmonizimi i regjistrave të pasurisë jo kapitale në mes të regjistrit të E- pasurisë dhe raportit të inventarizimit, si dhe regjistrimi në detaje i pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2025 ishin 2,487,372€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,961,206€, taksa komunale 352,573€, qiraja nga prona publike 82,504€, taksa komunale për leje ndërtimi 13,105€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 77,894€.

Çështja B4 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,487,372€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,961,206€, taksa komunale 352,573€, qiraja nga prona publike 82,504€, taksa komunale për leje ndërtimi 13,105€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 77,894€. Vetëm tatimi në pronë është rritur për 421,971€ në krahasim me vitin 2024.

Kjo kishte ndodhur si shkak i menaxhimit jo efikas të llogarive të arkëtueshme nga ana e komunës për mbledhjen e borxheve tatimore.

Ndikimi Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,282,624	16,028,784	15,612,453	15,693,066	13,336,901
Grante Qeveritare - Buxheti	14,148,552	14,426,464	14,252,852	14,426,726	11,969,774
Të bartura nga viti i kaluar	0	408,555	390,343	640,595	548,628
Të hyrat vetanake	1,134,072	1,134,072	947,810	615,551	720,276
Donacionet vendore	0	53,018	20,858	10,194	75,885
Donacionet e jashtme	0	6,674	590	0	22,337

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 746,160€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të Qeverisë, të hyrave të bartura nga viti i kaluar, si dhe donacioneve.

Në vitin 2025, Komuna e Kamenicës ka shpenzuar 97% të buxhetit final apo 15,612,453€, me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin e kaluar.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,282,624	16,028,784	15,612,453	15,693,066	13,336,901
Pagat dhe mëditjet	9,185,435	9,463,347	9,450,840	10,717,383	8,672,076
Mallrat dhe shërbimet	2,422,098	2,455,404	2,347,996	2,000,816	1,770,900
Komunalitë	262,000	262,000	261,893	242,275	206,760
Subvencionet dhe transferet	885,000	885,000	883,691	756,596	620,588
Investimet Kapitale	2,508,091	2,963,033	2,668,033	1,975,996	2,066,576
Rezervat	20,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike buxhetore janë dhënë si më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur për 277,912€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 9,450,840€, që paraqet rreth 100% realizim të buxhetit final.

-Buxheti final për mallrat dhe shërbime është rritur për 33,306€ krahasuar me buxhetin fillestar. Realizimi për vitin 2025 është 2,347,996€, që paraqet rreth 96% të buxhetit final.


-Buxheti për komunalitë ka mbetur i pandryshuar në 262,000€. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 261,893€, që përfaqëson rreth 100% realizim, duke treguar menaxhim të qëndrueshëm të kësaj kategorie.

-Buxheti për subvencionet dhe transferet ka mbetur i njëjtë në 885,000€, ndërsa realizimi është 883,691€, që paraqet rreth 100% realizim. Krahasuar me vitet paraprake, kjo kategori ka shënuar rritje të vazhdueshme.

-Buxheti final për investimet kapitale është rritur për 454,942€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 2,668,033€, që përfaqëson rreth 90% të buxhetit final.

-Buxheti i planifikuar prej 20,000€ për rezervat nuk është përfshirë në buxhetin final dhe nuk ka pasur realizim gjatë vitit 2025.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 ishin 1,134,072€, ndërsa realizimi i tyre ka arritur në 932,667€, që paraqet rreth 82% realizim të planifikimit. Realizimi i të hyrave lidhet me arkëtimin nga tatimi në pronë, taksa për lejet e ndërtimit, taksat rrugore, qiraja, tarifat për lëshimin e certifikatave, si dhe nga shërbime të ndryshme administrative.

Po ashtu, Komuna për vitin 2025 ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë 251,628€, të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga gjykatat në vlerë prej 6,780€ si dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 49,960€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga institucionet përkatëse dhe i alokohen Komunës për shpenzim.

Struktura e të hyrave paraqitet si në vijim:

- Të hyrat tatimore janë realizuar në vlerë prej 430,994€, që paraqet rreth 79% të planifikimit;
- Të hyrat jo tatimore janë realizuar në vlerë prej 493,663€, që përfaqëson rreth 83% të planifikimit;
- Të hyrat tjera janë realizuar në vlerë prej 8,010€, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara.

Krahasuar me vitin 2024, të hyrat janë rritur për 191,290€, ndërsa krahasuar me vitin 2023 vërehet rënie prej 224,800€, duke reflektuar luhatje në performancën e mbledhjes së të hyrave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	1,134,072	1,134,072	932,667	741,377	1,157,467
Të hyrat tatimore	542,113	542,113	430,994	300,136	595,993
Të hyrat jo tatimore	591,959	591,959	493,663	441,212	559,618
Të hyrat tjera	0	0	8,010	30	1,856

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, ne kemi identifikuar se një rekomandim ishte pjesërisht i zbatuar dhe katër (4) të tjerat nuk janë zbatuar ende.

Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se për angazhimet për shërbime të veçanta dhe detyra specifike, aplikohen procedurat e prokurimit sipas kërkesave ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjen adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet harmonizimi i regjistrave të pasurisë jo kapitale në mes të regjistrit të E- pasurisë dhe raportit të inventarizimit, si dhe regjistrimi në detaje i pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Ka filluar regjistrimi i pasurisë duke përfshirë përshkrimin e pasurisë me përcaktim të lokacionit.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi

	
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	Komuna e Kamenicës Opština Kamenica Kamenica Municipality

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z, Kdri Rahimaj

Pozita: Kryetar i Komunës

Data: 09. Qershor 2026

Nënshkrim:



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.